



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE



**amshc**

Agjencia për Mbështetjen  
e Shoqërisë Civile

# STRATEGJIA AFATGJATË 2022-2026

Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2024–2026, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 si dhe bazuar në Vendimin Nr. 539, datë 25.7.2019 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për politikën e Qeverisë drejt një mjedisi mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 -2023", i rishikuar dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Udhërrëfyesi, përditëson dhe rishikon përgatitjen dhe zbatimin për një plan të ri strategjik për të drejtuar/rritur përpjekjet e saj për të transformuar dhe evidentuar veten:

- Si një motor thelbësor në zhvillimin kombëtar të Shqipërisë në rrugën drejt Integritit në BE.
- Si një donator i standardeve evropiane, i barabartë me agjencitë e tjera të ngjashme të Evropës dhe rajonit.
- Si një donator/grantdhënës që ka në fokus "Transparencën" dhe "Cilësisën" në financimin dhe monitorimin e projekt-propozimeve.
- Si një donator në gjendje jo vetëm të financojë projekte, por të sigurojë asistencë teknike për shoqërinë civile të një cilësie të lartë, analiza, konsultime publike duke qenë një Institucion me një ndikim që siguron një ndikim të plotë në vendimmarrje dhe politikë bërje.

Strategjia e Agjencisë për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile për 2022 – 2026 njeh dhe vlerëson përpjekjet e jashtëzakonshme dhe investimet e nevojshme për të ndërtuar dhe bërë më operacionale punën e AMSHC-së që nga krijimi i saj si Institucion. Procedurat dhe rregullat për grant marrje janë instaluar dhe zhvilluar tashmë duke pasur në fokus gjithnjë e më shume digjitalizimin e procedurave për rritje të efikasitetit në punë dhe transparencës në publik.

E megjithatë, që prej vitit 2009 e në vijim, është e nevojshme të ndërmerren aksione të reja për të vendosur një nivel të ri të funksionimit të AMSHC-së në një nivel të ri të përmirësimit si nga pikpamja teknike ashtu dhe administrative.

Strategjia e re përcakton qëllime strategjike për të cilat Bordi Mbikëqyrës do të marrë përgjegjësinë për të arritur. Këto janë:

- **Qëllimi 1: AMSHC vazhdon të stabilizohet si një organizatë/institucion transparent dhe i drejtë në procesin e grant-dhënies, me një Bord Mbikëqyrës me performancë të lartë në shërbim të interesave më të mira të shoqërisë civile shqiptare**
- **Qëllimi 2: AMSHC forcon bashkëpunimin ndër-institucional mes qeverisë dhe shoqërisë civile duke shërbyer si urëlidhëse për një mjedis mundësuesh për shoqërinë civile**
- **Qëllimi 3: AMSHC forcon kapacitetet njerëzore dhe teknike të administratës së saj dhe përmirësn infrastrukturën digjitale për procedurat e financimit**
- **Qëllimi 4: Procedurat e AMSHC-së dhe raportet mbi impaktin e projekteve (grant-marrjes) janë në interes të shoqërisë shqiptare dhe komuniteteve vulnerabël.**

- **Qëllimi 5: AMSHC është një kanal i besueshëm për donatorët e huaj në lidhje me shpërndarjen e granteve.**

**Ndërkohë, krahas qëllimeve të lartpërmendura, AMSHC synon të arrijë objektiva të tillë afatgjatë si më poshtë vijon :**

1. **“Zhvillimi i kapaciteteve të shoqërisë civile”**: Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile përmes trajnimeve, grantëve dhe programeve që rrisin kapacitetet e tyre për të ndikuar pozitivisht në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.
2. **“Promovimi i pjesëmarrjes qytetare”**: Inkurajimi i angazhimit qytetar dhe i dialogut midis institucioneve publike dhe shoqërisë civile për të forcuar demokracinë dhe transparencën në vendimmarrje.
3. **“Sigurimi i mbështetjes financiare”**: Ofrimi i financimeve dhe granteve për projekte që kontribuojnë në zhvillimin social, ekonomik, dhe kulturor, si dhe në fuqizimin e grupimeve të marginalizuara.
4. **“Rritja e bashkëpunimit ndërsektorial”**: Zhvillimi i partneriteteve mes sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve komplekse sociale dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm.
5. **“Monitorimi dhe vlerësimi i ndikimit”**: Vendosja e mekanizmave të qartë për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të mbështetura, për të siguruar transparencën dhe efektivitetin e financimeve të bëra nga agjencia.
6. **“Promovimi i vlerave të demokracisë dhe të drejtave të njeriut”**: Nxitja e respektimit të të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike përmes mbështetjes së iniciativave që synojnë përmirësimin e qeverisjes dhe përfshirjes sociale.
7. **“Ndërtimi i kapaciteteve për vetëqëndrueshmëri”**: Ofrimi i mbështetjes për organizatat e shoqërisë civile për të ndërtuar modelet e tyre të qëndrueshmërisë financiare dhe për të diversifikuar burimet e financimit.

Së bashku, këto synime janë të hartuara në mënyrë të tillë që të konsolidohen procedurat dhe masat e marra për funksionimin e AMSHC-së si dhe për të hedhur bazat për të ardhmen e Agjencisë. Në të njëjtën kohë ato janë ambicioze dhe shumë prej tyre mund të kenë nevojë për të vazhduar në periudhën e ardhshme strategjike. AMSHC-ja duke përbërë mekanizmin qendror për financimin publik të programeve të OSHC-ve në Shqipëri, ka përpara saj sfida dhe punë për përmirësimin e funksionimit të saj, e sidomos për ripërcaktimin e rolit dhe punës së saj që të jetë më proaktive dhe afër OSHC-ve në nivel vendor, programimin transparent të prioritetëve të financimit, mbledhjen e të dhënave gjithnjë e më besueshme mbi OSHC-të dhe mbështetjen e zhvillimit të balancuar të shoqërisë civile në të gjithë vendin. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përgatitjes së kriterëve dhe procedurave të qarta për alokimin e granteve institucionale për OSHC-të, pasi ato janë shtypa kryesore për qëndrueshmërinë e OSHC-ve të udhëhequra drejt misionit.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërisë Civile

Për të siguruar monitorim sa më efektiv të punës së AMSHC-së dhe harmonizimin e prioriteteve për financim si me planet strategjike kombëtare ashtu edhe me nevojat e OSHC-ve AMSHC-ja duhet vijojë të marrë pjesë aktive në punën e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) në zbatim të Ligjit Nr.115/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile”, duke luajtur me efikasitet dhe përgjegjësi rolin e Sekretariatit të Këshillit, dhe duke shërbyer si urëlidhëse për forcimin e bashkëpunimit dhe dialogut ndërinstytucional mes qeverisë shqiptare dhe sektorit të shoqërisë civile.<sup>2</sup> KKSHC-ja është një organ kolegjal këshillimor, autonom, pranë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i rregulluar me ligjin nr.115/2015.

Në të njëjtën kohë për arritjen e këtyre objektivave strategjike nevojitet forcim i mëtejshëm i kapaciteteve të stafit të Agjencisë, në mënyrë që të fitojë besimin e shoqërisë civile dhe të publikut të gjerë në integritetin dhe ndershmërinë e saj.

Bordi mbikëqyrës do të mbikëqyrë zbatimin e planit strategjik, Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e saj.

## **Natyra unike dhe Karakteristikat e AMSHC**

AMSHC është një agjenci unike në Europë në atë që është një agjenci qeveritare e pavarur shqiptare, e financuar me një mandat të caktuar me ligj për të shërbyer dhe për të forcuar sektorin e shoqërisë civile në vend. Duke u financuar nga buxheti qendror i shtetit, ajo ka një nivel të qëndrueshëm, të financimit dhe është përgjegjës për tatimpaguesit shqiptar.

Kjo natyrë unike e Agjencisë e lejon atë për të zhvilluar strategji dhe prioritetet në interesin më të mirë të zhvillimit të vendit. Prioriteti për të mbështetur edhe të gjitha OJQ-të e reja është një tjetër faktor i rëndësishëm dallues i AMSHC e cila e lejon atë që të angazhohen me shoqërinë civile shqiptare në një mënyrë më gjithëpërfshirëse.

Si një agjenci që vepron në një mjedis ku shumë OShC janë skeptike, i gjithë stafi i AMSHC-së wshtw i gatshwm për të marrë masa për të përmirësuar perceptimin e transparencës dhe drejtësisë të Agjencisë

Përveç kësaj, karakteri kombëtar i Agjencisë e lejon atë për të bashkëvepruar në një rrafsh gjeografik më të shtrirë në të gjithë vendin dhe për të ndërtuar marrëdhënie edhe me organizata dhe komunitetet të shtrira në zonat rurale dhe të izoluar. Duke iu përgjigjur shoqërisë shqiptare, si një përbërës kryesor, AMSHC duhet të jetë rregullisht e angazhuar me shoqërinë civile shqiptare. Në këtë mënyrë, AMSHC duhet të jetë aktive dhe pjesëmarrëse e vazhdueshme në sektorin e shoqërisë civile të vendit.

<sup>2</sup> Udhërrëfyese për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërisë Civile

## Analiza e kontekstit të shoqërisë civile dhe funksionimit të AMSHC-së

Në një analizë të përgjithëshme sektori i shoqërisë civile në vend karakterizohet nga një sfidë e madhe por në të njëjtën kohë optimiste. Dokumenti strategjik kryesor që rregullon një mjedis mundësues për sektorin e shoqërisë civile është Udhërrëfyeni për shoqërinë civile 2019-2023.

Krijimi i një mjedisi mundësues për organizatat e shoqërisë civile është një nga parakushtet dhe masat për një demokraci të qëndrueshme në një shtet modern. Ky mjedis, duhet të garantojë kushte të favorshme fiskale dhe ligjore për shoqërinë civile dhe të krijojë hapësirë për lirinë e medias, institucionet e pavarura, lirinë e fjalës, si dhe për të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit. Një nga veçoritë bazë të qeverive demokratike është detyrimi i shtetit për të qenë në shërbim të qytetarëve të tij. Dialogu dhe bashkëpunimi mes autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile janë në interesin e drejtpërdrejtë dhe në të mirë të publikut dhe, rrjedhimisht, një parakusht për mirëfunksionimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse. Bashkëpunimi i mirë midis një qeverie me mendësi të orientuar drejt shërbimit dhe një shoqërie civile aktive, kritike dhe konstruktive përbën një element të domosdoshëm të demokracisë pluraliste,

<b>Konteksti shoqëror</b>	
1	Në vend ka një numër të madh të organizatave të shoqërisë civile. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë raportoi 7,580 OShC të regjistruara deri në fund të vitit 2017, të cilat janë edhe të dhënat e fundit të disponueshme mbi madhësinë zyrtare të sektorit të OShC.
2	Qeveria shqiptare është shumë më e hapur për të bashkëpunuar në mënyrë tepër konstruktive dhe efikase me organizatat e shoqërisë civile. Organizimi dhe funksionimi i AMSHC-së në vetvete mund të konsiderohet si një tregues i qeverisjes dhe shprehje e hapjes për bashkëpunim. Njeherazi shprehje e forcimit të dialogut me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në procesin e hartimit të politikave publike është miratimi me Vendimin Nr. 539, datë 25.7.2019 ”Për miratimin e Udhërrëfyesit për politikën e Qeverisë drejt një mjedisi mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019 -2023”
3	Qytetarët shqiptarë – veçanërisht grupet vulnerabël janë gjithnjë e më shumë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre si dhe të angazhohen publikisht për mbrojtjen e tyre.
4	Organizatat e shoqërisë civile në vend kanë zgjeruar lidhjet dhe shtimin e rrjetëzimeve me organizata partnere në Europë, me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të tyre.
5	Organizatat e shoqërisë civile janë në përgjithësi të gatshme të zhvillohen dhe të përqafojnë trendet inovative.

E megjithatë shoqëria civile përballet me një sërë sfidash. Sfidat kryesore me të cilat përballet shoqëria civile sot janë:

- Si shoqëria civile ashtu edhe popullsia/komuniteti në vetvete kanë një lloj skepticizmi megjithë vullnetin e Qeverisë shqiptare si dhe angazhimin e saj për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm që inkurajon pavarësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile, duke kontribuar në tejkalimin e hendekut mes qytetarëve dhe institucioneve.

- Vazhdojnë të dominojnë sektorin organizatat e shoqërisë civile të përqendruara në Shqipërinë qendrore, sidomos në Tiranë. Organizatat e tjera janë të përhapura kryesisht në Veri (Shkodër) dhe në Jug (Korçë, Fier dhe Vlorë).
- Procesi i regjistrimit vazhdon të jetë i centralizuar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke përbërë shqetësim për OSHC-të jashtë kryeqytetit. OSHC-ve u nevojitet të udhëtojnë drejt kryeqytetit jo vetëm për t'u regjistruar, por edhe për të bërë ndryshime në statut përfshirë adresat.
- Organizatat lokale janë më pak prezente dhe me mungesë të kapaciteteve teknike dhe organizative, për këtë shkak kanë pamundësi në thithjen e fondeve nga donator të ndrrshëm (megjithëse AMSHC-ja në thirrjet e saj për projekt propozime ka pasur si synim një shpërndarje sa më të gjerë gjeografike si dhe organizatat e reja.
- Shoqëria civile ende vuan në gjetjen qarkullimin e vullnetarëve megjithë ligjin Për Punën Vullnetare I cili synon rregullojë punën vullnetare me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën shoqërore, përmirësimin e cilësisë së jetës
- Mjedisi ligjor lidhur me rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për blerje të kryera me grante të donatorëve OSHC-të përfitojnë përjashtim nga taksat dhe rimbursim të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për blerje të kryera me grante të donatorëve ende është problematike për shoqërinë civile.

### **Analiza gjendjes aktuale dhe arritjet e AMSHC-së**

Që prej themelimit të saj në vitin 2009, AMSHC prej nisjes së saj (start-up) ka bërë përpjekje të mëdha në investime, kapacitet menaxhuese, burime njerezore, procedurave për financim; rregulloreve, procedurave te moniotrimin, te raportimit etj. Gjatë viteve të para, AMSHC ka përdorur fondet në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit qeveritar. Pjesa më e madhe e këtyre përpjekjeve kanë qenë burokratike dhe operationale. Si një agjenci e re me një staf relativisht të vogël, ky proces ka qenë i lavdërueshëm.

Në këtë moment, nevojitet të përmirësohen procedurat për shpërndarjen e fondeve publike të cilat janë përshkruar vetëm në ligjin për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (ASCS) dhe rregulloret e tjera të brendshme të ASCS-së.

#### ***Forca Aktuale dhe Arritjet***

**Fillimi.** Qe nga krijimi i saj ; AMSHC ka krijuar nje sere prioritetesh funksionale kryesore te tilla si monitorimi, raportimi, mbikeqyrja financiare dhe administrimi (shiko aneksin B Struktura aktuale e personelit).

Agjensia ka shpallur thirrje per projektpropozime çdo vit buxhetor dhe disbursuar me shume se 400 grante per OSHC –te shqiptare me mesatarisht 70 projekte në vit. Si disbursimi i granteve po ashtu dhe monitorimi I tyre jane aplikuar ne perputhje me ligjin dhe procedurat financiare qeveritare.

***Shtrirja deri tek Shoqeria Civile Shqiptare.*** Stafi I AMSHC ka udhetuar ne qytetet ne te gjithe rajonet e Shqiperise vecanerisht per te arritur dhe per t'u perfshire me te gjitha grupet e shoqerise civile lokale. Këto takime informimi dhe konsultimi jane mbajtur për të mbledhur të dhëna,

çështje që shqetësojnë dhe nteresojnë keto grupe dhe per t'i trajnuar ato rreth objektivave dhe procedurave të Agjensise per financimin e granteve .

**Perpjekjet per te rritur besimin dhe transparencen.** *Stafi I* AMSHC eshte i fokusuar teresisht ne nevojën për të ndertuar besimin dhe transparencën ndërmjet shoqërisë civile dhe taksapaguesve shqiptar. Kjo është adresuar kryesisht përmes shtrirjes dhe respektimit strikt të rregullave dhe rregulloret që kanë lidhje me ngritjen dhe monitorimin e granteve. AMSHC ka bërë publike financimet dhe grantet e saj dhe të gjitha procedurat lidhur me to tashmë edhe në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet një Programi cilësor dhe interaktiv Transparence në faqen zyrtare online të Institucionit.

Si dëshmi e këtyre arritjeve, AMSHC ka llogaritur se sasia e aplikimeve ka ardhur në rritje në mënyrë të qëndrueshme në secilën thirrje të re për propozime por edhe cilësia e projekteve si në relaizimin e aktiviteteve por edhe në raportim, është gjithnjë e më shumë në përmirësim duke dëshmuar rritje të kapaciteteve teknike dhe burimeve njëzëzore të OJF- ve dhe Shoqërisë Civile në vend. Ndërkohë që shumë OSHC në mënyrë të natyrshme kanë nevojë për financim me grant, kjo është gjithashtu një shenjë se gjithnjë e më shumë OSHC janë mirenjohese AMSHC-se dhe duan të jenë partnere me te.

### **Objektivat strategjike të AMSHC për periudhën 2022-2026**

Ashtu siç është përshkruar më sipër AMSHC ka arritur shumë në vënien në punë të elementeve mekanike të operacioneve procedurave dhe teknikave efikase në grantdhënie dhe monitorim. **SHËNIM:** *Duhet theksuar se ky është një plan strategjik. Bordi Mbikëqyrës do të udhëheqë për të arritur synimet dhe objektivat strategjike të listuara në këtë plan. Drejtori dhe stafi i tij do të realizojnë planin përgjatë periudhës së strategjisë.*

#### **Vizioni i Agjencisë**

AMSHC është një motor i rëndësishëm në zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin në BE, në partneritet, motivimin, dhe pajisjen e shoqërisë civile për të arritur impakt të qëndrueshëm.

#### **Misioni i Agjencisë**

Për të inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare për të mirën e dhe në interes të publikut.

#### **Vlerat kyçe të AMSHC-së:**


- Mbështetje e vazhdueshme për zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin evropian
- Angazhimi për shoqërinë civile shqiptare
- Përputhshmëria me ligjet shqiptare
- Transparenca
- Drejtësi
- Profesionalizmi

**Vizioni i AMSHC-së**

AMSHC është një motor i rëndësishëm në zhvillimin e Shqipërisë dhe integrimin në BE, në partneritet dhe mbështetjen e vazhdueshme të shoqërisë civile për të arritur impakt të qëndrueshëm.

**Misioni i Agjencisë**

Misioni I Agjencisë është zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë civile dhe krijimi i kushteve të favorshme për nisma qytetare për të mirën dhe interesin e shoqërisë.





**Synimi 1: AMSHC vazhdon të stabilizohet si një organizatë/institucion transparent dhe i drejtë në procesin e grant-dhënies, me një Bord Mbikëqyrës me performancë të lartë në shërbim të interesave më të mira të shoqërisë civile shqiptare**

**Objektivat:**

1: Afërsitë e Bordit Mbikëqyrës, bashkëpunimet dhe mekanizmat menaxhues, janë optimizuar për vendimmarrjen strategjike të saj dhe qeverisjen e AMSHC-së

1.2 Mekanizmat për vendosjen e prioriteteve dhe përzgjedhjen e granteve janë forcuar dhe përshtatur me parimin e gjithëpërfshirjes

**Synimi 2: AMSHC forcon bashkëpunimin ndër-institucional mes qeverisë dhe shoqërisë civile duke shërbyer si urëlidhëse për një mjedis mundësues për shoqërinë civile**

**Objektivat:**

2.1: AMSHC njihet gjerësisht si sekretariat i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile

2.2: AMSHC rrit transparencën e punës së KKSHC-së përmes informacioneve të vazhdueshme rreth veprimtarisë së Këshillit dhe mirambajtjes së faqes zyrtare online të KKSHC-së.

2.3: AMSHC në cilësinë e sekretariatit teknik të KKSHC forcon procesin e këshillimit mes shoqërisë civile dhe institucioneve publike si edhe ndjek kërkesat e OJF-ve rreth zbatimit të Udhërrefyesit për një mjedis Mundësues të Shoqërisë Civile.

**Synimi 3: AMSHC forcon kapacitetet njerëzore dhe teknike të administratës së saj dhe përmirëson infrastrukturën digjitale për procedurat e financimit**

**Objektivat:**

3.1: AMSHC është një avokat dhe promotor efektiv për shqetësimet e shoqërisë civile.

3.2: AMSHC është një forcë inovative për shoqërinë civile, përmes asistencës teknike dhe financimit

3.3: Staf i AMSHC-së ka kapacitetin teknik për të menaxhuar programet dhe transferimin e njohurive tek shoqëria civile

3.4: Procesi i aplikimit të granteve është transparent dhe më efikas nëpërmejt procesit të digjitalizimit

**Synimi 4: Procedurat e AMSHC-së dhe raportet mbi impaktin e projekteve (grant-marrjes) janë në interes të shoqërisë shqiptare dhe komuniteteve vulnerabël.**

**Objektivat:**

4.1: AMSHC ka përmirësuar kapacitetin dhe mekanizmat për të vendosur fushat prioritare të grndhënies sipas nevojave të komuniteteve dhe për monitoruar në mënyrë efektive grantet e saj

4.2: AMSHC tregon vlerën, ndikimin dhe kontributet në zhvillimin e synimeve kombëtare, evropiane dhe globale nëpërmjet grant-dhënies

**Synimi 5: AMSHC është një kanal i besueshëm për donatorët e huaj në lidhje me shpërndarjen e granteve.**

**Objektivat:**

5.1: AMSHC njihet si organizatë me reputacion, grand-dhënës i besueshëm nga donatorët të huaj

5.2: AMSHC shpërndan dhe menaxhon të paktën 20% të buxhetit vjetor me financimet e donatorëve të jashtëm